EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15.9.2026, me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina - kryesues, Donjeta Dragusha – LDK, Dhurata Jahaj Retkoceri – LDK, Amir Simnica – LDK, Plator Gërdovci – PDK, Fjolla Vukshinaj Reçica - PDK, Muhamet Selmani – PDK, Gëzim Sveçla – LVV, Nora Kelmendi LVV, Kreshnik Smajlaj – AAK, Arbenita Murseli Haxholli – Lidhja e Prishtinës.

Në mbledhje morën pjesë: Isah Mustafa, drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Behar Krasniqi, zyrtar nga Drejtoria e Bujqësisë, Luftar Braha, drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Inovacionit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesi i Komitetit, z. Fehmi Kupina, me këtë

REND TË DITËS:

1. **Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe të katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa;**
2. **Projektrregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, nr. 01/110-2782, dt. 2.12.2011;**
3. **Informatë rreth zbatimit të planit vjetor dhe rekomandimeve të Auditorit të brendshëm;**
4. **Propozim-vendimi për miratimin e Strategjisë për "Arti dhe Kulturën 2026 – 2031";**
5. **Propozim-vendimi për vënie në diskutim publik për ndryshim-plotësimin e Rregullores së orarit të punës dhe mbrojtjes nga ndotja akustike në sektorin e gastronomisë;**

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

6. **Propozim-vendimi për caktimin e Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet;**
7. **Propozim-vendimi për miratimin e Raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, janar - qershor 2026;**
8. **Të ndryshme.**

Pika e parë
Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe të katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa.
Me 9 vota për, 2 abstenime, u miratua ekstrakti i mbledhjes së tretë dhe të katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë
Projekt-rregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, nr. 01/110-2782, dt. 2.12.2011.
Luftar Braha - lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, tha se në këtë draft të Rregullores substanciale që është taksa e akomodimit e cila shtohet edhe është zona e kufizuar e trafikut, e cila është edhe me hartë pjesa e Unazës së brendshme të qytetit, si dhe tarifa për këtë pjesë. Po ashtu, ka rafinime të tërë Rregullores, ka edhe ndarje në shtojca për të menaxhuar më letë në të ardhmen, ka edhe ndarje në shtojca për me e menaxhuar më lehtë në të ardhmen.
Prandaj, çfarëdo ndryshimesh që duhet bërë në tarifa, munden me u ndryshuar vetëm shtojcat pa pasur nevojë me u ndryshuar teksti ose ku ka nevojë me u ndryshuar teksti, ndryshohet vetëm teksti pa pasur nevojë me u ndryshuar shtojcat, pasi që kjo është për lehtësi më të madhe, si dhe për përcjellje më të lehtë për çfarëdo ndryshimi të Rregullores në të ardhmen.
Sa i përket dëgjimit publik, tha se kemi pasur jashtëzakonisht shumë komente, si p.sh. nga Oda e Avokatëve, Oda e Noterëve, Oda e Farmacistëve, pastaj nga qytetarët, ku të gjitha shprehjet dhe komentet e tyre i kemi marr parasysh, si dhe ku ka qenë e mundur i kemi implementuar të gjitha në këtë projekt-rregullore të cilën e keni përpara.
Ai në vazhdim tha se në këtë Projekt-rregullore ka një metodikë të vendosjes për tarifa, ku ka një prerës që përcaktohet tarifa në bazë të disa parametrave matës për disa kategori të bizneseve, siç janë ndikimi në trafik, ndikimi urban, ndikimi social, ndikimi në ngarkesa administrative komunale. Pra për secilën kategori është dhënë një poentim, ku në bazë të atij poentimi ka dalë brezi i cili ka një pjesë arbitrare, ndoshta që duhet me qenë në brezin e lartë, ose të poshtëm , ose të mesëm, varësisht prej kategorive.

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

Nora Kelmendi shtroi pyetje se a është dërguar kjo Rregullore në departamentin ligjor për të bërë spastrimin ligjor, si dhe a ju ka dhënë komente departamenti ligjor, pasi që thatë se keni bërë analiza dhe çfarë analiza keni bërë për këto tarifa. Desha të dijë se kush i ka qitur këta parametra matës me qenë se unë nuk kam marrë pjesë në dëgjime publike.

Luftar Braha lidhur me pyetjen e shtruar nga znj. Kelmendi, tha se në kapitullin e fundit, si shtojcë, jo pjesa e Rregullores, por si pjesë përshkruese e metodikës, është metodologjia e cila i ka disa kategori: **e para** është pesha ekonomike sektoriale dhe kompleksiteti tipik i sektorit; **e dyta** është gjenerimi i trafikut, **e treta** është përdorimi i infrastrukturës, **e katërta** është ndikimi mjedisor, **e pesta** është kompleksiteti ose ngarkesa administrative, **e gjashta** është ndikimi urban dhe siguria dhe **e shtata** është pesha strategjike, ku në peshën strategjike kemi nënkuptuar bizneset ë cilat në njëfarë forme kanë nevojë për përkrahje, ose e kanë njëfarë sentimenti social dhe historik që ne duhet t'i ruajmë dhe t'i kemi pjesë aty, e atyre u shtohet me minus tek pesha strategjike që me u munduar mos me i ngarkuar.
Sa i përket Komisionit të punës, tha se pjesë e komisionit të punës për këtë Rregullore ka qenë një anëtare e deleguar nga Zyra ligjore e cila i ka validuar jo vetë të gjitha, por i ka validuar me Zyrën ligjore edhe nga juristët nga jashtë, që do të thotë se është e validuar.

Fjolla Vukshinaj Reçica shtroi pyetje se kush kanë qenë ata anëtarë të jashtëm, të cilët të kanë ndihmuar në strukturim apo në draftim të kësaj rregulloreje.
Ndërsa pyetja e dytë ka të bëjë me pagesën për të hyrë brenda Unazës së brendshme se si do të mblidhen paratë, a është menduar ndonjë laurë (rampë) apo ndonjë metodë tjetër, ose ndoshta është e shkruar por un nuk e kam parë, për çka kërkoj falje.
Ajo në vazhdim tha se më ka ardhur një rekomandim prej Odës së Farmacistëve, ndonëse personi që ka qenë në takim, që ne nuk jemi kundër kësaj pagese prej 300 eurove, por kanë kërkuar nga "Prishtina Parking" një bashkëpunim, që para lokaleve të farmacive që i kanë me e pasur një hapësirë ku ata mund t'i parkojë veturat.

Luftar Braha – lidhur me pyetjen e znj. Vukshinaj se kush kanë qenë të jashtëm në pjesën e grupit punues, po, kemi pasur, ata kanë qenë konsulentë të jashtëm, po them privat, që ua kam dërguar edhe juve.
Ai mes tjerash tha se kemi marrë komente të shumta për këtë në "Facebook", ku kanë komentuar se ku është metodologjia dhe cila është metodologjia, e kjo na bie në përgjigjen e pyetjes së tretë, që ka të bëjë me avokatët se si i kemi zbritur.

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

Ai në vazhdim tha se tek avokatët kemi të drejtë të ndërhyjmë, sepse nuk na ndalon asnjë ligj, as Kushtetuta e as profesionet e lira me i tarifuar. Mirëpo kjo metodologji e ka nxjerrë çmimin se sa është ngarkesa e tyre e jo më në mënyrë arbitrare.

Plator Gërdovci, duke u ndërlidhur në diskutim, tha se duke e analizuar këtë Rregullore, pash se shumica e tarifave apo ngarkesave nuk po mundem me i gjetur se janë të bazuara në ligj.
Prandaj kish pasur dëshirë që mundësisht të na sqarosh pak më gjerësisht çështjen e tarifave, pasi që nga viti 2007 e tutje Qeveria e Republikës së Kosovës e ka pasur një strategji për zvogëlimin e tarifave për bizneset.

Luftar Braha theksoi se, sa i përket strategjisë për uljen e pagesave, që është bërë prej qeverisë, jemi në dijeni për atë pjesë, por Komunat jetojnë ose kanë një pjesë të madhe të buxhetit prej të hyrave vetanake, që është një prej elementeve kryesore që i mban komunat dhe qeverisjen lokale në këmbë dhe në funksion.
Ai njëherësh tha se ka një ligj, e ai është Ligji për Financat dhe pushtetet lokale, në të cilën është thirrur Rregullorja, pastaj ka një Ligj për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Kryeqytetin.
Pra, janë tri ligje bazë, të cilat janë të miratuara nga e njëjta qeveri, prej të njëjtit Kuvend, pra të Kuvendit të Kosovës, dhe të cilat janë në fuqi.
Ai mes tjerash tha se ne nuk mundemi thjesht me ia mbyllur biznesin pse nuk e ka paguar tarifën, por ne mundemi me e quar në përmbarim, mundemi me e mbyllur biznesin për tri ditë apo për tetë ditë e me radhë, duke iu shkaktuar kështu bizneseve probleme të tilla operimi.
Mirëpo kam besim të plotë nëse ne jemi në zbatim të plotë të kësaj Rregulloreje, që kjo është e zbatueshme, dhe nëse na e rregullojnë ekipet tona me u regjistruar dhe me u koordinuar edhe me ARBK-në, edhe me Administratën Tatimore për me e zbatuar dhe me e bërë një regjistër të saktë.

Amir Simnica - duke u ndërlidhur në diskutim, shtroi pyetje se si kemi me qenë ligjërisht me këtë punë, pasi që palët të cilat ndëshkohen apo gjobiten për shkelje të kësaj Rregullore, secili prej tyre i drejtohen instancave ku kanë të drejtë të bëjnë ankesë. Prandaj, mos të votojmë diçka, të diskutojmë, apo të shterim kohë aq shumë, pasi që një ankesë na e rrëzon krejt këtë, pra le të jetë e qartë kjo, kurse të tjerat i diskutojmë edhe në seancë.

Gëzim Sveçla lidhur me diskutimet që u bënë nga parafolësit paraprak, shtroi pyetje, duke pyetur se kjo Rregullore a është bërë me qenë e mirë në kuptimin e përmbajtjes, apo me qenë edhe e zbatueshme, sepse nëse nuk është e zbatueshme, atëherë ajo do të mbetet vetëm një dokument i mirë diku në sirtarët e Komunës.

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

Mendoj se përtej asaj me pasur përfshirjen sa më të madhe të kategorive të cilat tarifohen apo taksohen. Besoj se do të ishte mirë me qenë e rrugës që tarifat të jenë më të ulëta, kurse mundësia e implementimit më e madhe.

Fjolla Vukshinaj Reçica theksoi se, duke e ditur se ka një Rregullore të vjetër, po ashtu edhe vendime, pasi që duke e ditur se edhe avokatët kanë taksë komunale, shtroi pyetje se a janë mbledhur edhe më herët taksat dhe a ka funksionuar kjo.

Luftar Braha lidhur me pyetjen e shtruar nga znj. Reçica, tha se më herët ka pasur vetëm 18 kategori të bizneseve, avokatët nuk kanë qenë, kurse taksat janë mbledhur te niveli ku mblidhen taksat komunale.

Muhamet Selmani tha se në këtë Rregullore i pashë tarifat për të gjitha llojet, si p.sh. pronat publike, afarizmin etj., por nuk pash për hapësirat bujqësore dhe ato të pyjeve, andaj shtroj pyetje se cila ka qenë arsyeja që nuk janë vendosur tarifat për këto dy kategori, apo mos ndoshta kjo Rregullore nuk i përfshinë këto të dyja si kategori.

Luftar Braha, sa i përket bujqësisë, tha se ne duhet ta kemi në interes të madh me e zhvilluar dhe me stimuluar sa më shumë bujqësinë, ku ndoshta në të ardhmen sa më shumë me i regjistruar e jo me i tarifuar.
Ndërsa sa i përket pyjeve, është Agjencia e Pyjeve, dhe ne nuk kemi kompetenca për pyjet.

Pika e tretë
Informatë rreth zbatimit të planit vjetor dhe rekomandimeve të Auditorit të brendshëm.
Osman Bllaca tha se për vitin 2026 kemi hartuar planin vjetor, mirëpo na është miratuar si informatë me vonesë nga ana e kryetarit, se ne si Njësi për auditim e kemi hartuar me kohë, do të thotë gjatë vitit 2025, në dhjetor, ashtu siç e parasheh afati kohor.
Pra, i kemi përcjellë tek kryetari, mirëpo ka pasur vonesë prej kryetarit, prandaj jam detyruar me e tërheq në tri auditime, ku dhe kemi bërë ndryshim të planit vjetor. Ndërsa për vitin 2026 e kemi paraparë me i bërë dhjetë auditime, si dhe një auditim me kërkesë. Nga kryetari kanë qenë dy auditime me kërkesë, që e ka plotësuar normën, një ka qenë për projektin ESCO, që është për ndriçimin publik që është bërë. Po ashtu ka kërkuar edhe për disa lëndë të Zyrës ligjore që kanë të bëjnë me ndërlidhshmërinë e procedimit procedural të Zyrës ligjore dhe përfaqësimin që e bën në Gjykatë.
Pra, atë raport e kemi veç në përfundim dhe nuk e keni pjesë të raportit të punës të cilin e kemi prezantuar.

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

Ai në vazhdim tha se deri në periudhën për gjashtëmujorin e parë janë përfunduar pesë raporte, si p.sh. është raporti për Drejtorinë e Arsimit, për Drejtorinë e Financave, që ka të bëjë me pjesën e pasurisë, për Drejtorinë e Administratës, për Drejtorinë e Inspeksionit, si dhe për Drejtorinë e Investimeve Kapitale, por nuk është pjesë këtu. Si dhe në total janë dhënë 23 rekomandime, ku prej tyre vetëm shtatë janë të implementuara, ndërsa pesë të tjera kanë qenë në proces të zbatimit, si dhe njëmbëdhjetë të tjera nuk ka filluar fare zbatimi i tyre.
Ai mes tjerash tha se janë edhe pesë auditime të tjera që duhet me i përfunduar, ku disa prej tyre veç kamë filluar, si dhe dy të tjera do t'i përfundoj, pra planin e përfundoj deri në fund të vitit total, ashtu siç e kam planifikuar, kuptohet se prej se jam drejtor, tash e tetë vjet planin e implementoj 100%.

Donjeta Dragusha shtroi pyetje se gjatë hartimit të planit për auditimin e brendshëm, a i merrni parasysh fushat e rrezikut të auditimit paraprak të ZKA-së, pasi që nëse ka fusha të rrezikut që i ka paraqitur ZKA-ja për vitin pasues, është mirë që auditimi i brendshëm me u fokusuar tek fushat e rrezikut që paraqiten nga raporti i ZKA-së.
Ndërsa pyetja tjetër është se a ka kapacitet njësia e auditimit të brendshëm me bërë auditime me kërkesë, çoftë nga ndërmarrjet apo institucionet tjera varëse të Komunës.

Osman Bllaca lidhur me auditimin e performancës tha se është kryer, e ai është auditimi për menaxhimin e pasurisë, që është raport pak më ndryshe se raportet tjera se matë edhe indikatorët tjerë të performancës. Kurse për pjesën e dytë është edhe për Drejtorinë e Parqeve, ku bëhet auditimi i performancës për krijimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra, ku tash e tri vjet bëjmë auditime të përformancës dhe jemi trajnuar dhe specializuar dy auditorë për këtë fushë, e ato janë Behare Sopjani dhe Advije Kuqi, që bëjnë auditime, po ashtu edhe unë jam certifikuar për auditime të përformancës dhe tash e tri vjet i bëjmë auditimet e përformancës.

Nora Kelmendi shtroi pyetje se a i ka përgatitur ekzekutivi planet e veprimit, pasi që u tha se rekomandimet nuk kanë filluar, prandaj më intereson se kur kanë me filluar planet e veprimit, në mënyrë që me filluar zbatimi i këtyre rekomandimeve. Ajo në vazhdim tha se do të ishte mirë nëse i kanë përgatitur, që t'i kemi edhe ne në material këto plane të veprimit.

Osman Bllaca lidhur me pyetjen e znj. Kelmendi, tha se njëra prej drejtorive nuk e ka hartuar ende dhe tjetra është në diskutim, për shkak të ndryshimeve që i ka pasur. Ai në vazhdim tha se prej gjashtë auditimeve që janë bërë vetëm dy nuk i kanë hartuar planet e veprimit, ku ndoshta edhe kjo është si pasojë e mos zbatimit

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

të rekomandimeve, sepse një prej problemeve të mëdha është niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve të auditorit të brendshëm.
Ai mes tjerash tha se ishte dashur edhe kryetari me i monitoruar këto, apo të caktojë ndonjë person adekuatë që merret me këtë specifikisht, me atë që edhe neve si njësi me na ndihmuar në zbatimin e rekomandimeve.

Nora Kelmendi tha se po pyes se keni shumë të gjetura nga auditori i jashtëm. Me pasur auditimin e brendshëm në rregull, atëherë të gjeturat me siguri kishin qenë minimale.
Prandaj edhe e kërkova planin e veprimit 2026, nëse e keni përpiluar.

Osman Bllaca lidhur me diskutimin e znj. Kelmendi, tha se është e vërtetë, por tash varësisht prej fushës dhe ku bëhet e gjetura e auditimit.

Muhamet Selmani lidhur me raportin e Auditimit tha se kur është folur për auditimin e Drejtorisë së Arsimit, ku janë cekur disa të meta, sidomos tek mungesa e një përshkrimi të plotë në mes të menaxherit të kontratës dhe implementuesit, pastaj auditimi tek Drejtoria e Inspeksionit, ku është cekur se nuk janë proceduar me kohë shumica e lëndëve, si pasojë e vonesës së procedimit të lëndëve, pastaj auditimi tek Drejtoria e Financave dhe Administratës, që ka të bëjë me regjistrimin e pasurive, prandaj më intereson shkaku, se mos ndoshta është në pyetje mungesë e stafit, neglizhenca apo mungesë e personave adekuatë për procedimin e lëndëve dhe formimit të Komisioneve.
Pyetja e fundit është se askund në rekomandimet të cilat janë bërë, nuk kam parë rekomandime për masa të mëtutjeshme ndaj përgjegjësve.

Osman Bllaca sa i përket Komisionit për inventarizim, tha se kjo i takon direkt drejtorit të Administratës, drejtor kanë qenë Valbona Ajeti dhe Arben Kçira, të caktuar me vendim të kryetarit, ku për të dytë ka pasur kërkesë që me u bërë Komisioni për inventarizim qysh e kërkon edhe Rregullorja 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo kapitale.
Ai në vazhdim tha se kërkohet ekskluzivisht të bëhet në çdo fundvit inventarizimi i pasurisë së paluajtshme, por komisioni nuk e ka formuar. Kjo i takon direkt drejtorit të Administratës, po ashtu edhe ZKA-s, në këtë rast edhe kryetarit të Komunës, që është i obliguar paralelisht me e bërë. Informatën e ka pasur edhe kryetari, edhe drejtori përkatës, asokohe ushtrues detyre e drejtorit, por nuk e kanë bërë.
Ai mes tjerash tha se esenca është që inventarizimin ku përgjegjës është drejtori, që është dashur me e bërë dhe me e caktuar, por njëkohësisht përveç Drejtorisë së Administratës që e ka përgjegjësinë për menaxhim të pasurisë për të gjitha institucionet përgjegjësinë për menaxhimin e pasurisë, duhet ta ketë edhe

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

Drejtoria e Shëndetësisë për të gjitha institucionet varëse, që i ka 34 institucione, po ashtu edhe Drejtoria e Arsimit, që i ka mbi shtatëdhjetë e sa objekte, duhet me u bërë inventarizimi për secilën.

Muhamet Selmani lidhur me diskutimin e z. Bllaca, tha se problemi këtu është ose neglizhenca e menaxherit të kontratës, ose është pamundësia e tij me e bërë këtë si rezultat i numrit të madh që e ka në implementim.
Pra, kjo është që mua më intereson, ose është neglizhenca e një personi, pasi që askund nuk kam parë rekomandime për procedim të mëtutjeshëm si auditor që jam, si dhe t'i e ke obligim me dhënë një rekomandim të tillë nëse është neglizhencë.

Osman Bllaca duke u ndërlidhur në diskutim, tha se rekomandimet i kemi shkruar, ku thuhet se rekomandohet që menaxheri i kontratës të sigurojë zbatim të plotë të detyrave dhe përgjegjësive të tij, duke përfshirë monitorimin e vazhdueshëm të kontratës, verifikimin e mbushjes së obligimeve nga operatori ekonomik, ku gjithashtu menaxheri duhet të ndjek trajnime, pasi që ne e konsiderojmë se nuk e ka aftësinë për menaxhim.

Pika e katërt
Propozim-vendimi për miratimin e Strategjisë për arti dhe kulturën 2026 – 2031.

Isah Mustafa lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, tha se dokumenti përmban pesë objektiva strategjik, pra është e drejta për të krijuar, e drejta për qytetin, zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit kulturor dhe krijues, kujtesa kolektive dhe gjithëpërfshirëse dhe e dekolanizuar dhe reformat administrative.
Ai në vazhdim tha se në aspektin praktik kjo synon më shumë programin për edukimin artistik, zhvillimin profesional për artist, fond për artin publik, rezidenca profesionale dhe përfshirje më të madhe të komunitetit në kulturë. Përveç kësaj, synojmë edhe aktivizimin e hapësirave publike për kulturë, inventarizim e tyrë dhe krijimin e mekanizmave më të qartë për përdorimin e tyre nga artistë dhe Shoqëria civile.
Një komponent i rëndësishëm është zhvillimi ekonomik i sektorit kreativ përmes investimeve në infrastrukturë, ristrukturim të financimit publik, mbështetje të stafeve kulturore dhe zhvillimin e turizmit kulturor.
Mirëpo vlen të ceket se strategjia parasheh edhe digjitalizimin dhe rrjetëzimin e arkivave të Prishtinës dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, duke e lidhur zhvillimin e së ardhmes me kujtesën dhe intensitetin e qytetit, ku njëherësh dokumenti identifikon edhe projektet e rëndësishme, si p.sh. Qendra Multikulturore e Gërmisë, Pallati i Rinisë, Kino Rinia etj.

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

Gëzim Sveçla shtroi pyetje se çka është duke ndodhur me teatrin "Dodona", pasi që ka kohë e gjatë që nuk ka pasur shfaqje.

Isah Mustafa – lidhur me pyetjen e shtruar nga z. Sveçla, tha se është e vërtetë se teatri "Dodona" është lënë pak pas dore, mirëpo kam pasur takime me drejtoreshën e insititucionit dhe jemi shumë afër dizajnimit për thirrjen për hapjen e atij teatri, ku kemi diku mbi 70 mijë euro për shfaqje të mbrëmjes dhe teatrit të kukullave.

Fjolla Vukshinaj Reçica shtroi pyetje se si do të bëhet monitorimi i kësaj strategjie, a do të bëhet përmes ndonjë organizate të shoqërisë civile apo përmes Drejtorisë së Kulturës.

Isah Mustafa lidhur me pyetjen e shtruar nga znj. Vukshinaj Reçica, tha se monitorimi do të shkojë përmes Drejtorisë së Kulturës, por do të jetë edhe një grup ndërinstitucional që përfshinë edhe organizatat dhe shoqërinë civile, por duke mos i anashkaluar edhe institucionet qendrore dhe lokale të cilat në një mënyrë kanë aktivitete në plan të veprimit.

Donjeta Dragusha shtroi pyetje se cilat janë ndryshimet substanciale prej draftit fillestar që ka dalë në dëgjim publik me draftin final që ka ardhur në Kuvend për miratim.

Isah Mustafa duke u ndërlidhur me diskutimin, tha se unë nuk e kam parë versionin e parë të draftit dhe nuk kam qenë pjesë e ekipit në të kaluarën, por me marrjen e detyrës të cilën e ushtroj, e kam parë draftin final dhe jam njoftuar në pika të shkurta lidhur me dokumentin.
Mirëpo e di se të gjitha komentet si ato nga shoqëria civile, nga organizatat, nga artistët janë inkorporuar në draftin final.

Pika e pestë
Propozim-vendimi për vënie në diskutim publik për ndryshim-plotësimin e Rregullores së orarit të punës dhe mbrojtjes nga ndotja akustike në sektorin e gastronomisë.

Luftar Braha lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, tha se kjo Rregullore është miratuar para tri viteve, por ka pasur pengesa në zbatim. Prandaj tendenca është që me nxjerrë në diskutim publik, që me e parë prej sektorit të gastronomisë se cilat janë pritjet e tyre dhe cilat janë pengesat që kanë pasur me Rregullore, si dhe me pasur formulime të duhura në aspektin e ndotjes akustike të sistemeve të ndotjes akustike, si duhet të zbatohen, si dhe normave të zbatimit të

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

inspeksioneve, që d.m.th. kompetencat e inspeksionit për me i zbatuar këto në plotni.

Amir Simnica duke u ndërlidhur në diskutim, tha se lidhur me ndotjen akustike kemi diskutuar shumë herë në mandatin e kaluar, ku kemi pas filluar me i vendos mjetet speciale për matjen e zhurmës nëpër lokale. Mirëpo projekti i cili, sipas meje dhe qytetarëve të cilët më drejtohen mua, është projekt i dështuar.
Ndërsa sa i përket ankesave që janë bërë nëpër lokacione të ndryshme, ku vetëm unë i kam përmbi pesë ankesa për një lokacion që ka të bëjë me një lokal tek ndërmarrja banesore "Dukagjini", ku ndodhet një diskotekë.

Luftar Braha tha se ai është një projekt i shpallur dhe i dështuar, që d.m.th. kontraktori ka dështuar me e liferuar projektin në tërësi për arsyet e veta, të cilat neve nuk na interesojnë, ku ne nuk kemi pasur dëme financiare.
Ndërsa bizneset të cilat kanë paguar ne i kemi të regjistruara dhe do t'ju ofrojmë pajisje të reja.

Fjolla Vukshinaj Reçica shtroi pyetje lidhur me taksën prej 10 mijë eurove, a ka qenë gjithmonë kështu, që klubet e natës taksohen në këtë mënyrë.

Luftar Braha lidhur me pyetjen e shtruar nga znj. Vukshinaj Reçica, tha se klubet e natës ashtu taksohen dhe ashtu paguajnë.

Arbenita Murseli Hagjolli shtroi pyetje se sa herë duhet të gjobitet një lokal derisa t'i merret leja.

Luftar Braha lidhur me pyetjen e shtruar nga znj. Murseli Hagjolli, tha se saktësisht këto janë problemet për të cilat po propozohet për të shkuar në dëgjim publik dhe me u rregulluar këto probleme, që janë mësuar prej praktikës gjatë këtyre viteve dhe nuk kanë lejuar zbatushmëri.

Pika e gjashtë
Propozim-vendimi për caktimin e Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet.

Kjo pikë e rendit të ditës është lënë për diskutim në mbledhjen e radhës.

Pika e shtatë
Propozim-vendimi për miratimin e Raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, janar – qershor 2026.

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

Behar Krasniqi lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, tha se para juve kemi sjellë raportin e vlerësimit të dëmeve për periudhën janar – qershor të këtij viti, ku është cekur baza ligjore në bazë të së cilës kemi vepruar dhe kemi bërë vlerësimin.
Ndërsa sa i përket aktivitetit të komisionit të cilin e kemi ndërmarrë për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore, tha se kemi të bashkangjitur edhe numrin e kërkesave, e që gjithsej janë 46 kërkesa, ku 30 prej tyre janë të miratuara, 15 të refuzuara, si dhe një numër të kërkesave të përsëritura.
Ai në vazhdim tha se sa i përket kërkesave të miratuara, ku gjithsej janë 30 sosh, i kemi në fusha të ndryshme, p.sh. në bujqësi i kemi 16 raste, ku vlera e dëmit është 30 mijë euro e 803. 56, në ekonomi familjare, ku vlera e dëmit është 14 mijë e 484.84 euro, si dhe dëme të tjera, ku hyjnë dëmtimi i veturave nga rrëzimi i pemëve, vlera e dëmtimit është 3 mijë e 859.20 euro. Që do të thotë se vlera e dëmeve të shkaktuara gjatë periudhës janar – qershor është 49 mijë e 147.60 euro.
Në bazë të Rregullores përmes së cilës veprojmë, duhet të miratohet nga kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës, që me i dërguar në nivelin qendror, pra në Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave (AME).
Pra, presim miratimin tuaj.

Muhamet Selmani lidhur me raportin e vlerësimit të dëmeve, kur është bërë përmbledhja, tha se herën e kaluar për secilën kërkesë keni sjellë raportin e vlerësimit të bashkangjitur me fotot dhe vizitat e terrenit, tabelën e vlerësimit me të cilën kemi ardhur deri tek shuma, ndërsa tek ky raport nuk po i shoh.

Behar Krasniqi lidhur me diskutimin e z. Selmani, tha se secila lëndë i ka të bashkangjitura raportin e terrenit, raportin e vlerësimit, dëshmitë, fotot etj., mirëpo të gjithat janë në Kabinet të Kryetarit.

Muhamet Selmani shtroi pyetje se a keni informacion se a janë paguar dëmet nga vlerësimi i kaluar, sepse kam shumë kërkesa dhe telefonata nga bujqit e anës tonë, përderisa iu kam thënë se Komuna nuk merret me ato.
Pyetja tjetër është se a është kthyer raporti në rivlerësim?

Behar Krasniqi lidhur me pyetjen e shtruar nga z. Selmani, tha se në bazë të informacioneve që kam, pagesa nuk është bërë që nga viti 2023, prej se ka kaluar në Agjencinë për Menaxhim të Emergjencës. Ndërsa se a janë kthyer raportet për rivlerësim nuk kam dijeni, mirëpo mund të drejtoheni tek drejtori i emergjencave ose komisioni i kaluar.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

Procesmbajtësi/ja
Lendita Spahija

Kryesuesi i Komitetit
Fehmi Kuptina

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org